KY BULETIN ËSHTË SHTYPUR NË LETËR TË RICIKLUAR

BULETINI MJEDISOR

Numri #3 (Maj 2011) **Abonohu në: www.ks.undp.org**

I nderuari lexues,

Buletini Mjedisor vazhdon rrugëtimin e suksesshëm të tij. Ju keni në duart tuaja botimin e tretë të këtij publikimi. Shpresojmë që nëpërmjet këtij buletini ne ju sjellim informata të rëndësishme, interesante dhe të kualitetit të lartë. Ne ju inkurajojmë që të vazhdoni të na dërgoni raportet mbi aktivitetet tuaja. Qëllimi ynë është që ta thellojmë këtë bash-këpunim në mënyrë që ta pasurojmë përmbajtjen dhe llojllojshmërinë e temave për lexuesit tanë. Duke ju bashkëngjitur aktiviteteve që organizohen nëpër botë në kornizën e një mjedisi të shëndetshëm, të qëndrueshëm dhe me biodiveristet të pasur, në këtë numër në i vendosëm në fokus aktivitetet e institucioneve, shoqërisë civile dhe aktorëve tjerë për mbrojtjen e natyrës dhe të vlerave të trashëgimisë natyrore. Temat përfshijnë turizmin e qëndrueshëm, agro-pylltarinë, mbrojtjen e specieve dhe ngritjen e vetëdijes mjedisore. I falënderohemi të gjithëve që kanë kontribuuar në pasurimin e këtij buletini me tema dhe artikuj interesant.

Ekipi Redaktues

NË KËTË NUMËR

LAJME NGA VENDI

- Mbrojtja e Zogjve të Egër
- Turizmi i qëndrueshëm në male
- Ekspedita e Kërkimit në shpellën e Kanjonit të Madh
- Ngrohja e parë solare në qendrën shëndetësore
- Mbjellja edrunjëve të paqes
- Thuaji JO qeseve nga plastika

LAJME NGA REGJIONI

- Mbrojtja regjionale ndërkufitare e habitateve

MBROJTJA E ZOGJVE TË EGËR

Organizata Jo Qeveritare "Finch" nga Prizreni, është një nga organizatat e rralla në Kosovë, që përkujdeset për mbrojtjen e zogjve të egër. Aktivitetet e shumta të kësaj organizate në mbrojtjen e zogjve dhe të mjedisit të tyre kanë bërë që ajo të ketë më shumë se 100 anëtarë dhe përkrahës si dhe të ketë një bashkëpunim shumë të mirë jo vetëm me organizatat dhe institucionet vendore por edhe me ato ndërkombëtare. Organizimi i ekspeditave për vrojtimin e zogjve, është një prej aktiviteteve më të rëndësishme të Finch. Ky aktivitet ka zgjuar interesim jo vetëm për anëtarët e organizatës por edhe për shumë turistë të huaj. Përmes këtyre aktiviteteve Finch promovon edhe zhvillimin e turizmit malor dhe atij rural në Kosovë e në veçanti në Bjeshkët e Sharrit, Bjeshkët e Opojës dhe ato të Gorës. Vrojtuesit e zogjve gjatë këtyre ekspeditave kanë mundësi që krahas bukurive natyrore të shijojnë ushqimet tradicionale dhe të njihen me kulturën e banorëve të këtyre lokaliteteve. Monitorimi i llojeve të rrezikuara të zogjve në Malet e Sharrit dhe monitorimi i zogjve shtegtarë përgjatë rrjedhës së lumit Drin, janë po ashtu aktivitete të rëndësishme të organizatës, ndërkohë që janë të shumta edhe aktivitetet për vetëdijesimin e publikut për rendësinë e ruajtjes së zogjve. Në kuadër të këtyre përpjekjeve ishte edhe ekspozita e fotografive të zogjve të natyrës së Kosovës të realizuara nga vetë anëtarët e organizatës. Në kuadër të aktiviteteve të planifikuara për këtë vit është organizimi i kampingut malor "Limthi" i cili është tradicional dhe organizohet gjatë pushimeve verore. Qëllimi i tij është njohja me llojet e zogjve të egër të natyrës së Kosovës. Organizata Joqeveritare Finch, është një shembull unikat i veprimit të OJQ-ve në Kosovë edhe për faktin se shumicën e aktiviteteve i realizon në mënyrë vullnetare dhe nga fondet e anëtarësisë së saj. ◊



KY BULETIN ËSHTË SHTYPUR NË LETËR TË RICIKLUAR

BULETINI MJEDISOR

INFORMATA TË PËRMBLEDHURA

◊ Ndotja e ajrit në Prishtinë shpesh i kalon normat e lejuara sipas standardeve të BE-së, që paraqet një kërcënim për shkaktimin e sëmundjeve të rënda dhe të përsëritura të rrugëve të frymëmarrjes

◊ Rreth 80% e banorëve të zonave urbane kanë qasje në sistemin e kanalizimit

◊ Deponitë e shumta të paligjshme gjenerojnë rreziqe të shëndetit dhe tëmjedisit duke e ndotur tokën dhe burimet e ujit që gjenden nën to

◊ Disa restorante në Kosovë mbajnë arinj në kafaz në mënyrë të paligjshme, duke shkaktuar dëme të përhershme në sjelljet e tyre natyrore

TURIZMI I QËNDRUESHËM NË MALE

Zhvillimi i turizmit malor është njëra nga mënyrat më të mira për gjenerimin e të ardhurave lokale për popullatën dhe kësisoj kontribuon në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror. Për një vit, Komuna e Prizrenit në Kosovën jugore ka punuar në zhvillimin e turizmit malor në territorin e saj, duke përfshirë zonën e malit unik të Sharrit të mbështetur nga një regjion alpin Francez, Alpet Haute, Ambasada e Francës dhe Ministria e Punëve të Jashtme të Francës. Qëllimi kryesor i projektit "Turizmi i qëndrueshëm, mjet për zhvillimin territorial në zonat malore" do ta bëje Departamentin e Turizmit të Prizrenit operacional, efektiv dhe do ta finalizojë planin kryesor mbi turizmin; një udhërrëfyes për këtë regjion malor me bukuri dhe pasuri natyrore.

Aktivitetet tjera do të përfshijnë ndihmën Prizrenit që të zbatojë hapat e parë të planit dhe të zhvillojë partneritete me komunat fqinje në regjionin e malit të Sharrit. Përveç promovimit të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, turizmi i qëndrueshëm mundohet t'i shmanget gjenerimit të ndikimit negativ në kulturën dhe mjedisin lokal. ◊



Mali impresiv i Sharrit në Kosovën Jugore

EKSPEDITA E KËRKIMIT NË SHPELLËN E KANJONIT TË MADH

Shpella Gryka e Madhe në Grykën e Rugovës, është një bukuri e rrallë e nëntokës së Kosovës dhe një objekt interesant për shumë hulumtues. Vlerësohet se kjo shpellë është një ndër objektet natyrore më atraktive për realizimin e ekspeditave hulumtuese dhe turistike jo vetëm në masivin e Bjeshkëve të Nemuna por edhe në regjionin e Ballkanit Perëndimor. Gjatë muajit shkurt në këtë shpellë është realizuar një ekspeditë hulumtuese e organizuar si rezultat i bashkëpunimit në mes të Shoqatës së Speleologëve "Aragonit" nga Peja, Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe një ekipi të Speleologëve nga Republika e Sllovakisë. Gjatë kësaj ekspedite janë hulumtuar disa korridore dhe galeri të reja të shpellës të cilat nuk kanë qenë të eksploruara më parë. Korridoret dhe galeritë e hulumtuara janë të pasura me kristale që paraqesin vlera të rralla shkencore dhe turistike. Ekspedita të ngjashme me qëllim të hulumtimit të korridoreve dhe galerive tjera të pa eksploruara të shpellës do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Shpella Gryka e Madhe ndodhet në kilometrin e tetë të Grykës së Rugovës, rreth 90 m mbi shtratin e lumit Lumëbardhi i Pejës. Hyrja e shpellës gjendet në lartësinë mbidetare 637 m. Gjatësia e korridoreve dhe e galerive të hulumtuara është rreth 13.450 m. Është njëra ndër shpellat më të mëdha në Kosovë dhe regjion. Ajo është krijuar nga rrjedhja ujore në shkëmbinjtë e triasikut. Në brendësi të shpellës gjendën disa lumenj dhe liqe nëntokësorë të formave dhe madhësive të ndryshme, të cilët kanë ndikuar në zgjerimin e korridoreve dhe galerive nëntokësore. Vlerësohet se Shpella Gryka e Madhe ka vlera të rralla natyrore, shkencore, hidrike, biologjike, edukative-arsimore dhe turistike. ◊



SI MUND TË NDIHMONI NË MBROJTJEN E MJEDISIT!

↻ Lënia e pajisjeve elektrike në gatishmëri konsumon energjinë kot – fikni pajisjet tërësisht!

↻ Përpiquni të shmangni blerjen e sapunit në një enë plastike - zgjidhni sapunë pa to dhe të prodhuar ekologjikisht

↻ Ul përdorimin, ripërdor dhe riciklo në vend të blerjes



BULETINI MJEDISOR

KALENDARI MJEDISOR

2011-ta, viti ndërkombëtar i pyjeve

8 Maj
Dita ndërkombëtare e kryqit të kuq dhe gjysmë hënës së kuqe

31 Maj
Dita botërore pa duhan

5 Qershor
Dita botërore e mjedisit

8 Qershor
Dita botërore e oqeaneve

17 Qershor
Dita botërore e luftës kundër shkretëtirëzimit dhe thatësirave

NGROHJA E PARË SOLARE NË QENDRËN SHËNDETËSORE

Në Kosovë, energjia elektrike përdoret kryesisht nga familjet, industria dhe sektori i shërbimeve dhe ajo prodhohet kryesisht nga djegia e qymyrit linjit të cilësisë ulët. Zhvillimi dhe përdorimi i burimeve të energjisë së rinovueshme është vendimtar për Kosovën për shkak të niveleve në rritje të ndotjes së ajrit dhe në mënyrë që të ndiqet një model i qëndrueshëm mjedisor për një mjedis të pastër dhe të sigurt, me energji të sigurt dhe një ekonomi të fuqishme. Një pilot projekt për instalimin e një sistemi të ngrohjes solare të ujit në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Dragash, u zbatua nga UNDP-ja me mbështetjen e organizatës jo-qeveritare për energji AKEREE dhe financuar nga Qeveria e Finlandës për të nxitur përdorimin e paneleve solare për ngrohjen e furnizimit të ujit sanitar me ngritje të efikasitetit të energjisë dhe një furnizim të qëndrueshëm dhe të mjaftueshëm të ujit të nxehtë sanitar. Në mënyrë që të mbahet furnizim i qëndrueshëm me ujë të nxehtë gjatë vitit, është llogaritur se uji do të ngrohet me energji solare për nëntë muaj, ndërsa gjatë tre muajve të dimrit, uji do të ngrohet nga kaldajat me vaj të instaluar për ngrohje të hapësirës.

Rezultatet e pritshme të pilot projektit për dy muaj përfshijnë kursimet e energjisë elektrike prej 22.995 MWh/y, reduktimin e lirimit të CO2 prej 31.259 t/y, dhe reduktimin e kostos në konsumin e energjisë elektrike prej 2000 e/y. Si sistem i parë solar i ngrohjes në komunën e Dragashit, pilot projekti ka një vlerë të madhe demonstruese për komunitetin dhe të gjithë regjionin, duke përfshirë zbatimin e tij në të ardhmen në përpunimin e ushqimit dhe në amvisëri. ◊



Panelet solare në kulmin e qendrës shëndetësore

MBJELLJA E DRUNJVE TË PAQES

Që nga viti 2008 InterSilva, një organizatë jo-qeveritare, ka qenë e përfshirë në zhvillimin e pylltarisë në nivel të komunitet në Kosovë, së bashku me organizatat partnere lokale. Pylltaria në komunitet nxit dhe mbështet përfshirjen e njerëzve në marrjen e vendimeve dhe menaxhimin e burimeve të tyre lokale. Në Kosovë, pylltaria e komunitetit mund të krijojë "Infrastrukturën e gjelbër", ku hapësirat janë caktuar dhe mbillen me pemë dhe bimë të tjera zbukuruese apo të dobishme duke krijuar një mjedis të këndshëm dhe të sigurt. Kur menaxhohen në mënyrë të qëndrueshme, hapësirat e këtilla mund të japin dru zjarri, materiale të ndërtimit, dhe produkte jo-drusore si mjaltë dhe fruta. Ato gjithashtu ofrojnë një vendbanim të rëndësishëm për kafshët e egra që mbështesin diversitetin biologjik. Mbjellja urbane e drunjve mund të jetë pjesë e pylltarisë së komunitetit duke siguruar drunj të ri rrugë, mbjellje të drunjve rreth ndërtesave për të siguruar hije dhe zbukurim, dhe drunj në parqet e qytetit dhe oborre shkollore.

InterSilva ka projektin e vazhdueshëm "Drunjtë e paqes në Kosovë ", i projektuar për të mbjellë 2.5 milion drunj gjatë një periudhe pesë vjeçare me përfshirjen e fuqishme të komunitetit lokal. Kjo do të ndihmojë të krijohet një bazë për përpjekjet kombëtare për mbjelljen e drunjve në të ardhmen. Agro-Vet Zhvillimi është organizata partnere lokale e cila aktualisht e zbaton projektin në terren. Për të përfunduar fazën e parë të Projektit të Drunjve të Paqes në Kosovë, aktualisht janë duke u mbjellur drunj shtesë në Obiliq për të arritur objektivin e 10.000 drunjve. ◊



BULETINI MJEDISOR

THUAJI JO QESEVE NGA PLASTIKA

Me moton "Unë e dua Podujevën të pastër - Thuaju JO qeseve të plastikës!" organizata jo qeveritare Ekovizioni nga Podujeva u ka shpërndarë qytetarëve të kësaj komune qese pëlhure. Qëllimi i këtij projektit është informimi dhe vetëdijesimi i qytetarëve për dëmet që shkakton përdorimi i pakontrolluar i qeseve të plastikës. Përveç anëtarëve të organizatës aksionit i janë bashkuar edhe nxënës dhe vullnetarë të cilët kanë ndihmuar në shpërndarjen e qeseve të pëlhurës dhe përcjelljen e porosive për mbrojtjen e mjedisit. Shpërndarja e qeseve është bërë kryesisht në zonën urbane të qytetit. Përdorimi i pakontrolluar i qeseve të plastikës, përveç që ndikon në prishjen e imazhit të peizazheve natyrore dhe urbane, shkakton edhe dëme tjera mjedisit për faktin se riciklimi i tyre në kushte natyrore mundë të zgjasë deri në 400 vite. Qeset e plastikës janë të dëmshme në veçanti për shtazët. Sipas organizatave për mbrojtjen e shtazëve si pasojë e qeseve të plastikes çdo vit vdesin rreth 100.000 shtazë detare.

Vlerësohet se në nivelin global mbeturinat e plastikës përbëjnë 14-28 % të mbeturinave të përgjithshme. Ekovizioni është Organizatë Joqeveritare e cila aktivitetet i ka të orientuara në fuqizimin e rolit të rinisë dhe shoqërisë civile në mbrojtjen e mjedisit. ◊



MBROJTJA REGJIONALE NDËRKUFITARE E HABITATEVE

Bashkimi Evropian do të kontribuojë në ruajtjen e habitateve unike, florës dhe faunës, në zonën e Parkut të Prespës. Komisioni Evropian ka propozuar që BE-ja të ratifikojë një marrëveshje për të mbrojtur zhvillimin e qëndrueshëm të zonës së Parkut të Prespës në Evropën Juglindore. Marrëveshja u negociua nga Komisioni Evropian, Greqia, Shqipëria dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë. Liqenet e Prespës dhe mjedisi përreth tyre janë një zonë unike natyrore me rëndësi të madhe ekologjike, e cila do të ruhet më mirë përmes një trajtimi gjithëpërfshirës në nivel baseni. Marrëveshja është një hap ndryshimi në marrëveshjet ekzistuese të bashkëpunimit në nivel vendor dhe duhet të lehtësojë zbatimin e suksesshëm të qëllimeve të Direktivës Kornizë të Ujit të BE-se në këtë zonë. Zona e Parkut Prespa është përcaktuar si një zonë ndërkufitare e mbrojtur në mes të Greqisë, Shqipërisë dhe Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë duke qenë një shembull i një zone ndërkufitare të mbrojtur në Evropën Juglindore. Sipas marrëveshjes, palët do të detyrohen të menaxhojnë liqenet në mënyrë të kujdesshme, duke i kushtuar vëmendje të veçantë nivelit të ujit, parandalimit të ndotjes, ruajtjes së biodiversitetit si dhe zhvillimit të zonës në mënyrë të qëndrueshme. ◊



Zona e Parkut Prespa

Për numrin e radhës 9/2011, abonohu në: www.ks.undp.org

Versioni online: http://www.kosovo.undp.org/?cid=2,176

Ky buletin botohet në bashkëpunim mes Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë.

Ekipi redaktues: Afrim Berisha (MMPH), Rizah Hajdari (MMPH), Nadia Chaichee (UNDP) dhe Burbuqe Dobranja (UNDP).

SI MUND TË NDIHMONI NË MBROJTJEN E MJEDISIT!

- Angazhohu si vullnetar në iniciativat e gjelbra në komunitet



- Preferoni ecjen në këmbë dhe vozitjen me biçikletë, është e shëndetshme dhe pa lëshime të gazrave ndotës



- Preferoni përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë për energji elektrike